



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0627

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-Kryetare, Vedat Poterqoi-Referues dhe Agon Ramadani-Anëtar duke vendosur sipas ankesës së OE "D & T Group" SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me autoambulanca" me numër të prokurimit 206-23-5211-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Shëndetësisë, më 17/10/2023, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e "D & T Group" SH.P.K. me Nr. Protokolli 2023/0627, e datës 29/08/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me autoambulanca", me numër të prokurimit 206-23-5211-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoriteti Kontraktues (AK), ndërsa vendimi i AK lidhur me aktivitetin e lartcekur mbetet në fuqi.
2. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.05.2023, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me autoambulanca", me numër të prokurimit 206-23-5211-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 920,000.00 €.

Me 18.08.2023, OE "D & T Group" SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit për Kontratë B05. Me 23.08.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 29.08.2023, kudër vendimit të cituar si më sipër OSHP ka pranuar ankesën nga OE "D & T Group" SH.P.K., me Nr.Protokolli 627/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me autoambulanca”, me numër të prokurimit 206-23-5211-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "D & T Group" SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) Ankuesi pretendonse “Operatori Ekonomik D&T Group shpk, pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, në afatin paraparë me dispozitat e nenit 108/A, të LPP-së, e ka kundërshtuar propozimin për anulim të procedurës, ndërsa AK — Ministria e Shëndetësisë, në kundërshtim me paragrafin 6 të nenit 108/A, të LPP-së, pas afatit ligjor nxjerr vendim dhe refuzon kërkesën tone si të pa bazuar. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë. OE "D&T Group shpk, me datën 18.08.2023, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim ndërsa AK -Ministria e Shëndetësisë vendimin për refuzim të kërkesës e ka nxjerrë me datën 23.08.2023, pra është nxjerrë pas skadimit të afatit të përcaktuar me dispozita ligjore.”

Pretendimi i dytë (II): Ankuesi pretendon se “Autoriteti Kontraktues — Ministria e Shëndetësisë, në dosje të tenderit sa i përket pikës I, të eliminimit, tek kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional si dëshmi ka kërkuar: "Autorizim nga prodhuesi (ose dileri qe është i autorizuar nga prodhuesi) se jeni te autorizuar për shitje servisimin e autoambulancave që

ofertoni - Kopje e noterizuar. Operatori Ekonomik "D&T Group" shpk, për këtë procedurë të prokurimit, në ofertë ka prezantuar dëshmi konkrete përmes të cilave vërtetohet se plotësohet kërkesa kualifikuese. Në ofertë kemi prezantuar Letër Autorizimin e datës 04.07.2023, nga dileri "Mercom Company" shpk, i autorizuar nga distributori "Euroimpex", i prodhuesit Peugeot. Në letër konfirmimin e datës 06.01.2020 të distributorit "Euroimpex", shumë kuartë përcaktohet se, "Mercom Company" shpk, është përfaqësues i autorizuar, për shitjen e automjeteve të reja dhe për servisim të produkteve të prodhuesit Peugeot, për pjesë rezerve, për tere territorin e Republikës së Kosovës, ku i njëjti është i autorizuar të marr pjesë, të negocioj dhe të bart të drejtat dhe autorizimet, rrjedhimisht është e autorizuar që të bëjë mirëmbajtjen dhe të ofroj garanci tek autoritetet kontraktore.

Pretendimi i tretë (III): Ankuesi pretendon se “ Sa i përket arsytimit të eliminimit 2, në si Operator Ekonomik, po ashtu në ofertë kemi prezantuar fakte dhe prova shkresore ku, kemi plotësuar kërkesën e pozicionit nr. 8, të kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional, ku është kërkuar: "OE duhet të dorëzoj Vërtetim nga prodhuesi se do të mbështes distributorin e OE për se paku 10 Vite me pjesë rezervë për autoambulancë dhe 7 Vite për pajisje mjekësore", ndërsa si dëshmi dokumentare është përshkruar: "Kopje e vërtetimit nga prodhuesi". Operatori Ekonomik, në oferte ka prezantuar, dëshmi për garancinë edhe ndaj pajisje kryesore Autoambulancës, Deklarata e "Mercom Company" shpk, e dedikuar për kompaninë tone D&T Group shpk, i përfshirë edhe Autoritetin Kontraktues — Ministrin e Shëndetësisë, titulli dhe numri i aktivitetit të prokurimit, ku shumë kuartë përcaktohet se përfaqësuesi i autorizuar brendit Peugeot për Republikën e Kosovës, konfirmon se do të ofroj furnizime dhe mbështetje të plotë me pjesë rezerve për automjetet në afat prej 10 Vite pas dorëzimit të automjeteve...”

Pretendimi i katërt (IV): Ankuesi pretendon se “ AK — Ministria e Shëndetësisë, pas konstatimit të anëtareve të komisionit vlerësues të ofertave dhe rekomandimit për dhënie të kontratës, anulimi i aktivitetit të prokurimit me arsytim se në nuk i plotësojmë kërkesat 2 dhe 8 të kapacitetit teknik dhe profesional, paraqet shkëlqje të rendë të ligjit për prokurim publik sipas pikës k), të përcaktuar me nenin 97, të rregullores për Prokurim Publik nr. 001/2022...”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE "D & T Group" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 22, 23, 24, 52, 59, 62, 69, 108A të LPP si dhe neni 11, 40, 43 dhe 97 të Rregullores për Prokurim Publik duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues në OSHP që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 29/08/2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 627/23, ndërsa me datë 01/09/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0627 me rekomandimet si në vijim: “eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e papabuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.”

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është deklaruar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE ka deklaruar se e kundërshton në tërësi raportin e ekspertit shqyrtues duke rekomanduar që ankesa e tij të aprovohet si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “D &T Group” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0627 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankimor është i pa bazuar pasi që “*Eksperti shqyrtues konsideron qe me këtë rast data 18.08.2023 ka qenë ditë e premte dhe duke konsideruar që administrata nuk punon në ditën e shtunë dhe të diele konsideron që data 23/08/2023 kur edhe AK ka kthyer përgjigjen i bie dita e mërkurë pra në ditën e 3-të te fillimit të javës pas vikendit gjë që për ekspertin nuk paraqet ndonjë shkelje të dispozitave apo afateve duke konsideruar gjithnjë që edhe siç e ka cekur ankuesi në ankesën e tij duke cituar Nenin 108/A të LPP-së që afati prej 3 diteve mund të zgjatet edhe për 3 dite të tjera shtesë në rast nevoje. Eksperti mendon qe ky pretendim ankimor është i pabazuar.*

Pretendimi i dytë (II) ankimor është i pa bazuar pasi që “*Bazuar ne te dhënat e kërkuara dhe dokumentet e ofruara eksperti mendon qe me te drejte AK ka refuzuar këtë ofertë si të papërgjegjshme dhe se ky pretendim është i Pa Bazuar, duke konsideruar qe Dileri ne këtë rast i autorizuar për PEUGEOT nga Franca pra fabrika për prodhimin e automjeteve është kompania "EUROIMPEX DOO" nga Shkupi e cila është e autorizuar si distributor për Maqedoni, Kosovë, Serbi, Mal te Zi dhe Shqipëri dhe ne këtë rast kompania ne fjalë nga Shkupi ka të autorizuar vetëm kompaninë "MERCOCOM COMPANY" nga Prishtina për të marrë pjesë nëpër tenderë apo edhe të nënshkruaj kontrata në emër të automjeteve dhe përfaqësisë Peugeot.*

Pra, OE D&T Group në këtë rast si ofertues dhe ankues është deshtë që të merr autorizimin si për shitje ashtu edhe për garanci direkt nga Distributori apo dileri që është i autorizuar nga Prodhuesi pra qe i bie kompania nga Shkupi "EUROIMPEXX DOO SKOPJE" dhe jo nga nën distributori kompania Mercom në Prishtinë.

Pra, kompania e autorizuar nga prodhuesi PEUGEOT për territorin e Kosovës ka të autorizuar vetëm kompaninë MERCOM dhe jo kompaninë D&T Group për të marrë pjesë në tender apo të shes automjete te tipit peugeot. Ne këtë rast i bie qe OE ankues nuk ka autorizim direkt as nga prodhuesi e as nga distributori EUROIMPEX DOO SKOPJE, ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit. Kjo vërehet shumë mirë edhe në autorizimin në gjuhën angleze ku thuhet që kompania EUROIMPEX DOO autorizon kompaninë MERCOM për shitjen dhe pjesëmarrje në tenderë nga vetë kompania dhe nuk thotë askund siç edhe është pretenduar nga ankuesi që ky autorizim ju jep të drejtën që ti bartin të drejtat dhe autorizimet ndonjë kompanie tjetër brenda Kosovës.”

Pretendimi i tretë (III) ankimor është i pa bazuar pasi që *“Dokumentet, vërtetimet për ekspertin janë të papranueshme dhe bien ndesh me kërkesat themelore dhe të obligueshme të Dosjes së Tenderit, dhe me të drejtë AK ka konsideruar këtë ofertë si të papërgjegjshme ngase në këtë rast gjithçka do te ishte në rregull nëse në tender do të aplikonte direkt kompania "MERCOM" e autorizuar nga prodhuesi si dhe dileri për territorin e Kosovës dhe me gjerë, apo edhe nëse këto dy kompani do te hynin ne konsorciumi dhe sipas praktikave të mira nuk mund të ketë garancion të prodhuesit të bartur tek dy apo tre palë tjera siç pretendon ne rastin konkret operatori ankues.*

Pretendimi i katërt (IV) ankimor është i pa bazuar pasi që *“Eksperti konsideron qe ky pretendim është i pabazuar ngase në Rregulloren per Prokurim Publik nr.001/2022 Neni 11 mbi Funkcionet e Departamentit të Prokurimit **pika J** ku thotë që: Pas përfundimit te procesit te vlerësimit, ZPP shqyrton propozimin për kontrate te rekomanduar nga komisioni vlerësues, dhe pika k. ZPP pranon/refuzon rekomandimin e propozuar.”*

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “D & T Group” SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues. Me këtë rast Paneli Shqyrtues ka marrë në konsideratë edhe përgjigjen e dhënë nga OE ankues. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "D & T Group" SH.P.K.janë të pa bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes. Në këtë mënyrë është gjetur

se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me autoambulanca”, me numër të prokurimit 206-23-5211-1-1-1 si dhe që OE D&T Group në këtë rast si ofertues konform kërkesave të vendosura nga AK në DT është dashur që të pajiset me autorizimin si për shitje ashtu edhe për garanci direkt nga Distributori apo dileri që është i autorizuar nga Prodhuesi këtë rast i bie te jetë kompania nga Shkupi "EUROIMPEXX DOO SKOPJE" dhe jo nga **nën distributori** kompania "Mercom" në Prishtinë, Andaj me të drejtë eksperti në raportin e tij i është referuar "**autorizimit te prezantuar në ofertën**" sipas përmbajtjes së cilës vërehet se fare nuk ceket se autorizim i lëshuar për "Mercom" nga "Euroimpex Doo"-(Distributor i autorizuar i prodhuesit) mund të bartët edhe tek palët e treta siq është tani "D&T Group" apo siq pohon Ankuesi. Kurse përfundimisht OE ankues ka pasur mundësi që gjatë fazës së kriterëve ti atakojë kriteret e lartëcekura (*autorizim apo granacion nga prodhuesi për autoambulanca në rastin konkret*). Përfundimisht, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur seanka e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet sie pa bazuar dhe rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të Vërtetuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me autoambulanca”, me numër të prokurimit 206-23-5211-1-1-1 të datës 24.05.2023.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër duke ju referuar pohimeve ankimore të ngritura nga ankuesi, sipas gjeturave të ekspertit në këtë rast nuk përbëjnë bazë të mjaftueshme që ky aktiviteti i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën kjo do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktiviteti të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - "D & T Group" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: